



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 768/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të BOE “EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Sistemim asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi*”, me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

Ankimues:

BOE “EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k..
Adresa: Dibër, Melan, Veshaz.

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Dibër.
Adresa: Bulevardi “Eles Isufi”, Dibër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:


I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3 Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.



Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 20.07.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Sistemin asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi”, me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

II.2 Në datën 15.08.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.08.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------------------------------|
| i. "GJOKA KONSTRUKSION" sh.p.k | 43,032,185 lekë, skualifikuar; |
| ii. "EURALDI" sh.p.k & "CURRI" sh.p.k | 45,929,826 lekë, skualifikuar; |
| iii. "SELAMI" sh.p.k. | 49,750,177 lekë, kualifikuar; |
| iv. "VLLAZNIA NDËRTIM IS" & "NDREGJONI" sh.p.k | 50,726,241 lekë, skualifikuar |

II.4.Në datën 23.08.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 08.09.2017 pala ankimuese BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Në datë 04.10.2017 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin K.P.P 683/2017, ku vendosi:

1. *Të pranohet ankesën e BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me objekt "Sistemin asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi", me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.*
2. *Të pranohet ankesën e BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k., lidhur me shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
3. *Të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet duke i kualifikuar këta operator ekonomik.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k.*
6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.7.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin në datën 01.11.2017, sipas përcaktimeve në vendimin K.P.P 683/2017 dhe në datën 02.11.2017, me anë të vendimit K.P.P. 683/5/2017, Komisioni i Prokurimit Publik ka hequr pezullimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, duke lejuar autoritetin kontraktor të vijojë me procedurën e prokurimit.

II.8.Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.5496/1prot., datë 24.11.2017, me anë të të cilës, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, në të cilën konstatohet se në datën 06.11.2017, pranë autoritetit kontraktor, është paraqitur ankesë nga operatori

ekonomik "Selami" sh.p.k., me anë të së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me rikualifikimin e ofertës të BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k.. Ankesë e cila është pranuar nga komisioni i shqyrtimit të ankesave, i ngritur pranë autoritetit kontraktor Bashkia Dibër.

II.9.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin në datën 17.11.2017, duke e riskualifikuar ofertën e BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k.

II.10.Në datën 21.11.2017 BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për riskualifikimin e ofertës së tij, si dhe ka ngritur pretendime mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "SELAMI" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.11.Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.5496/1prot., datë 24.11.2017, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.12.Në datën 05.12.2017, BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, ky i fundit deklaron *inter alia* se "[...] Në datën 24.11.2017, nr.5496/1, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën për kualifikimin tonë[...]"

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1.Në datë 04.10.2017 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin K.P.P 683/2017, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me objekt "Sistemim asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi", me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.*

2. *Të pranohet ankesën e BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k., lidhur me shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
3. *Të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet duke i kualifikuar këta operator ekonomik.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k.*
6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

III.1.1.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin në datën 01.11.2017, sipas përcaktimeve në vendimin K.P.P 683/2017 dhe në datën 02.11.2017, me anë të vendimit K.P.P. 683/5/2017, Komisioni i Prokurimit Publik ka hequr pezullimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, duke lejuar autoritetin kontraktor të vijojë me procedurën e prokurimit.

III.1.2.Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.5496/1prot., datë 24.11.2017, me anë të të cilës, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, në të cilën konstatohet se në datën 06.11.2017, pranë autoritetit kontraktor, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "Selami" sh.p.k., me anë të së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me rikualifikimin e ofertës të BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k.. Ankesë e cila është pranuar nga komisioni i shqyrtimit të ankesave, i ngritur pranë autoritetit kontraktor Bashkia Dibër.

II.1.3.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin në datën 17.11.2017, duke e riskualifikuar ofertën e BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k.

II.1.4.Në datën 21.11.2017 BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për riskualifikimin e ofertës së tij, si dhe ka ngritur pretendime mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "SELAMI" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.1.5.Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.5496/1prot., datë 24.11.2017, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.1.6.Në datën 05.12.2017, BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, ky i fundit deklaroi *inter allia* se "[...] Në datën 24.11.2017, nr.5496/1, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën për kualifikimin tonë[...]"

III.1.7.Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik" është parashikuar: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji." "Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës". Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."

III.1.8.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues, si edhe aktit mbi trajtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se në datën 24.11.2017, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.5496/1prot., datë 24.11.2017 ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën duke mos e pranuar atë. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik të ndryshuar", parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrative pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis nga dita kur operatori ekonomik është njoftuar nga autoriteti kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës. Në rastin konkret,

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Por ankimi i dorëzuar pranë KPP nga BOE ankimues më datë 05.12.2017 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita kur BOE ankimues është njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës nga ky i fundit dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e BOE ankimues është datë 04.11.2017, (pasi dita e dhjetë që i përkon data 03.12.2017 është ditë pushimi) për këtë arsye ankesa e paraqitur prej këtij të fundit një ditë më vonë është pas përfundimit të afatit duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë K.P.P.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh” parashikohet se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, KPP gjykon se nuk mjafton vetëm pohimi i BOE ankimues për të vërtetuar datën e marrjes dijeni nga autoriteti kontraktor për vendimin mbi ankesën nga ky i fundit, por BOE ankimues duhet të kishte paraqitur prova fizike për të vërtetuar pohimin e tij. KPP konstaton se nuk ka provë tjetër për tu referuar mbi datën e njoftimit të BOE mbi shqyrtimin të ankesës, përveç shkresës së autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës e cila mban datën 24.11.2017 dhe për këtë arsye për llogaritjen e afateve, KPP e bën duke filluar nga data që mban akti i autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës.

III.1.9.Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k. pranë K.P.P. nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.10.Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga BOE ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Sistemim asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi”, me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.
 2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1792 Protokoli, Datë 05.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha